

VENDIM
Nr. 1086, datë 14.12.2013

**PËR KRIJIMIN E TASK-FORCËS PËR PËRMIRËSIMIN E NIVELIT TË ARKËTIMEVE DHE
ULJEN E NIVELIT TË HUMBJEVE NË SISTEMIN E SHPËRNDARJES SË ENERGJISË
ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e Task-Forcës për përmirësimin e nivelit të arkëtimeve dhe uljen e humbjeve në sistemin e shpërndarjes së energjisë elektrike.

- | | |
|--|------------------|
| 2. Kjo Task-Forcë drejtohet nga zëvendëskryeministri dhe ka në përbërje: | |
| - Ministrin e Energjisë dhe Industrisë | zëvendëskryetar; |
| - Zëvendësministrin e Energjisë dhe Industrisë | anëtar; |
| - Zëvendësministrin e Punëve të Brendshme | anëtar; |
| - Zëvendësministrin e Drejtësisë | anëtar; |
| - Zëvendësministrin e Financave | anëtar; |
| - Zëvendësministrin e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë | anëtar; |
| - Administratorin e “CEZ Shpërndarje” sh.a. | anëtar; |
| - Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Shtetit | anëtar; |
| - Drejtorin e Përgjithshëm të Ujësjellës-Kanalizimeve | anëtar. |

3. Task-Forca për përmirësimin e nivelit të arkëtimeve dhe uljen e humbjeve në sistemin e shpërndarjes së energjisë elektrike, ka këto funksione:

- Hartimin e një plani masash administrative dhe organizative për fuqizimin dhe rritjen e frytshmërisë së strukturave të “CEZ Shpërndarje” sh.a., për përmirësimin e nivelit të arkëtimeve, evidentimin dhe ndërprerjen e lidhjeve e të ndërhyrjeve të paligjshme në rrjetin e shpërndarjes dhe në sistemin e matjes së energjisë elektrike.

- Bashkërendimin e punës me strukturat e “CEZ Shpërndarje” sh.a. dhe institucionet e tjera shtetërore për identifikimin dhe zbatimin e masave në funksion të përmirësimit të nivelit të arkëtimeve të detyrimeve të energjisë elektrike.

- Bashkërendimin e punës me strukturat e “CEZ Shpërndarje” sh.a., për përcaktimin e zonave të rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike, për të cilat kërkohet ndërhyrje emergjente për zbatimin e masave teknike.

- Bashkërendimin e punës me strukturat e Policisë së Shtetit, sipas qarqeve, për mbështetjen e veprimeve në terren të punonjësve të “CEZ Shpërndarje” sh.a., gjatë ndërprerjeve të lidhjeve të paligjshme dhe ndërprerjeve për shkak të mosekzekutimit të detyrimeve të energjisë elektrike.

- Bashkëpunimin me strukturat e Policisë së Shtetit për ndjekjen me përparësi të kallëzimeve penale të depozituara nga “CEZ Shpërndarje” sh.a.

- Kontrollin e zbatimit të detyrave të lëna për njësitë operative vendore dhe institucionet e tjera të ngarkuara në përputhje me këtë vendim.

- Bashkërendimin e punës me Entin Rregullator të Energjisë për një program të posaçëm që përgatitet nga “CEZ Shpërndarje” sh.a., ku parashikohet kryerja e investimeve emergjente në funksion të uljes së humbjeve në rrjetin e shpërndarjes së energjisë elektrike në zonat më problematike.

- Evidentimin e nevojave emergjente për t’i paraprirë punës me ndryshimet e mundshme të kuadrit ligjor, nënligjor e rregullator, të cilat ndikojnë në përmirësimin e treguesve të nivelit të humbjeve e të nivelit të arkëtimeve të energjisë elektrike dhe përgatitjen e propozimeve përkatëse.

- Bashkëpunimin dhe bashkërendimin e punës me Entin Rregullator të Energjisë për masat e nevojshme rregullatore që duhet të merren për realizimin e funksioneve themelore të Task-Forcës.

4. Brenda datës 31 dhjetor 2013, nën drejtimin e prefektëve sipas qarqeve, të ngrihen njësitë

operative vendore, të cilat i raportojnë 1 (një) herë në muaj kryetarit të Task-Forcës për masat e marra dhe rezultatet e arritura për ndjekjen e detyrave të parashikuara në këtë vendim.

5. Task-Forca për përmirësimin e nivelit të arkëtimeve dhe uljen e humbjeve në sistemin e shpërndarjes së energjisë elektrike ndihmohet nga sekretariati teknik. Ngarkohet ministri i Energjisë dhe Industrisë për ngritjen e këtij sekretariati dhe për përcaktimin e përbërjes e të mënyrës së funksionimit të tij.

6. Periudha e veprimit të Task-Forcës të jetë deri më 31 dhjetor 2014.

7. Në mbledhjet e Task-Forcës, sipas problematikave që mund të konstatohen, ftohen të marrin pjesë ekspertë të fushës, përfaqësues të institucioneve të tjera të interesuara dhe të organeve të qeverisjes vendore, kur çmohet se pjesëmarrja e tyre do të jetë e vlefshme për përmbushjen e misionit të saj.

8. Ngarkohen zëvendëskryeministri, ministri i Energjisë dhe Industrisë, ministri i Punëve të Brendshme, ministri i Drejtësisë, ministri i Financave, ministri i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, drejtori i përgjithshëm i Policisë së Shtetit dhe administratori i “CEZ Shpërndarje” sh.a., për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama